



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:140492

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05714877

AC.nr.5156/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Besnik Bislimaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen Juridiko-Jokontestimore të **propozuesve**: I.B., I.B., B. B. dhe, N. B. të gjithë nga S. të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë Avokatët S. B.dhe G.E. nga P. Rr.xxxx, **kundër propozuesit**: Organi Shpronësues - Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetëror me seli në Prishtinë, me objekt shqyrtimi: *Kompenzim i Paluajtshmërisë së Shpronësuar*, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga kundër propozuesja Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, ushtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar Naime Abazi nga Prishtina, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm CN.nr.88/2016, të datës 10.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **20.05.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e kundër propozueses Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, ushtruar përmes përfaqësueses Naime Abazi nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër CN.nr.53/20, dt: 14.04.2021, në pikën **I, II** dhe **III** të dispozitivit të tij, **VËRTETOHET**.

II.Pika IV e dispozitivit të Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër CN.nr.53/20, dt: 25.05.2021, **ngel e pa shqyrtuar**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, në procedurën ri gjykuese, me aktvendimin e atakuar CN.nr.53/20 të datës 25.05.2021, ka vendosur si në vijim:

- I. **APROVOHET PJESËRISHT E BAZUAR KËRKESA E PROPOZIMIT** të propozuesve I. B. I. B. dhe N. B. të gjithë nga S., ashtu që:
- II. **OBLIGOHET Organi Shpronësues Qeveria e Republikës së Kosovës, që në emer të Kompenzimi Real** për ngastrat e shpronësuara në interes të përgjithshëm për ndërtimin e Autostradës Vërmicë- Merdare, P-2140-0 dhe 2139-4 ZK Suharekë të cilat janë marrë për nevoja të ndërtimit të autorrugës Vërmicë-Merdarë, propozuesve - Ankuesve çdo njërit nga 1/4 tu kompenzoj edhe shumën - diferencën prej 67,569.74€ si diferencë e çmimit të tokës së shpronësuar, që të gjitha këto me kamatë vjetore në lartësi prej 7% në vit duke filluar nga data e nxjerrjes së vendimit përfundimtar për shpronësim 27/04/2011 e deri në pagesën definitive, i vlerësuar sipas ekspertizës së ekspertit Adem Kadolli.
- III. **Detyrohet e Kundër propozuesi - Qeveria e Republikës së Kosovës** që në emer të shpenzimeve të procedurës, të paguaj propozuesve shumën në lartësi prej **3,932.80€** dhe atë për: Shpenzimet e njohura në procedurë paraprake sipas Aktvendimit CN.nr.42/17 në lartësi prej 1,566.80€, dhe **në ri procedurë** për 3 seanca **të pambajtura pa faj të propozuesve** nga 50% të shumës sikur të ishte mbajtur seanca (676€ për seancë) **338€ x 3 = 1,014€**, për 2 seanca të mbajtura nga 676€ shumën 1,352.0€ , të gjitha në afat prej 15 dite prej ditës së plotëfuqishmërisë së këtij Aktvendimi.
- IV. **REFUZOHET SI E PABAZUAR** Kërkesa e Propozimit sa i përket shpenzimeve të procedurës jokontestimore mbi shumat e gjykuara si në pikën III të dispozitivit të Aktvendimit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin e përcaktuar ligjor ankesë ka ushtruar kundër propozuesja Qeveria e Republikës së Kosovës- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në Prishtinë Naime Abazi, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës jo kontestimore, vërtetimit të gabuar të dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe duke marrë parasysh interesin juridik të parashtrueses së ankesës, konsiderohet se aktvendimin e ka goditur pjesërisht dhe atë vetëm sa i përket pikës I, II dhe III të dispozitivit të tij (pjesës aprovuese të propozimit), me propozim që të aprovohet ankesa e kundër propozueses – Qeveria e Republikës së Kosovës në tërësi si e bazuar, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm CN.nr. 53/20, dt: 14.04.2021, në pikat e atakuara me ankesë, të ndryshohet dhe refuzohet propozimi për caktimin e kompensimit, apo i njëjti aktvendim të priset dhe lënda të kthehet në ri vendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë, brenda afatit ligjor kan ushtruar propozuesit J. B. etj nga S., përmes të autorizuarit të tyre avokat S. B. nga P., duke i kundërshtuar të gjitha pretendimet ankimore të kundër propozueses të parashtruara dhe të pretenduara në ankesë si të pa bazuara dhe të pa argumentuara, me propozim që të refuzohet ankesa e kundër propozueses Qeveria e Republikës

së Kosovës, si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Themelore Prizren- Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e ankimuar, shqyrtimit dhe analizimit të provave, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), në pajtim me nenin 3 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore (LPJK-së), ka gjetur se:

Ankesa e kundër propozueses Qeveria e Republikës së Kosovës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-MPMH me seli në Prishtinë, ushtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në Prishtinë Naime Abazi është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rrjedh se propozuesit me datën 15.12.2010, kanë ushtruar propozim për caktimin e kompensimit në emër të shpronësimit të pronës së paluajtshme, ndaj kundër propozueses, - Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, duke kërkuar nga gjykata që të caktohet kompensimi në emër të shpronësimit të pronës së paluajtshme e cila është marrë për ndërtimin e autostradës Vërmicë-Merdar, dhe me precizimin e të njëjtit ka kërkuar shumën e kompensimit si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

I autorizuari i kundër propozuesit-organit shpronësues e ka kundërshtuar në tërësi kërkesën për kompensim, duke potencuar se vlerësimi i bërë nga organi shpronësues ka qenë në përputhje me udhëzimin administrativ 13/11 që kanë të bënë me metodat dhe kriteret teknik të vlerësimit, duke i kundërshtuar në tërësi ekspertizat e ekspertëve për vlerësimin e pronës së paluajtshme, me propozim që gjykata propozimin e propozuesve përtej shumës së caktuar nga organi shpronësues ta refuzoj të pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas kthimit të lëndës në ri gjykim, mbajtjes së seancave gjyqësore, nxjerrjes dhe administrimit të provave, duke vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, ka nxjerr aktvendimin e atakuar, me vendosje më të hollësishme si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me mënyrën e vendosjes, në arsyetimin e saj ka deklaruar se nga raport i përpiluar nga Organi i Shpronësimit - vlerësuesi IMOBILIA e datës 10.10.2010, Gjykata arriti të konstatoj se paluajtshmëritë e shpronësuar janë vlerësuar 6.5 euro për një metër katrorë.

Nga Raporti i Ekspertit ing.i bujqësisë Adem Kadolli e datës 25.02.2014, Gjykata konstatoi se ky ekspert ngastrën **P-2140-0 dhe P-2139-4** e ka vlerësuar 22€ për një metër katror.

Nga këto raporte të vlerësimit të ekspertit të pavarur dhe vlerësimit të bërë nga organi shpronësues, Gjykata vlerëson se i pamohueshëm është fakti se ka mospërputhje të madhe në mes vlerësimit të lartësisë së çmimit nga organi shpronësues, dhe ekspertit të caktuar nga Gjykata.

Nga shkresat e lëndës, është vërtetuar se sipërfaqja e tërsime e shpronësuar për ngastrat objekt shqyrtimi është 4367m² dhe me vendimin përfundimtar është kompenzuar shuma 28,504.26€, ndërsa mbi bazën e vlerësimit të ekspertit shuma shtesë që duhet ti paguhet propozuesve në emer të shpronësimit të ngastrave objekt shqyrtimi është në lartësi prej 67,569.74€.

Gjykata në riprocedurë duke vepruar në kuptim të nenit 359 paragrafi 1 të LPK-së, e ka ftuar ekspertin Adem Kadolli i cili në seancën e datës 19.03.2021 e ka elaboruar, e ka shpjeguar çmimin e caktuar nga ky ekspert për 2 ngastrat kadastrale që janë shpronësuar, ku eksperti ka theksuar se tek qmimi real për meter katror ka ardhur në bazë të udhëzimit administrativ 13/2011 të MF që ka të bëjë me përcaktimin e metodave të vlerave të paluajtshmërisë ku neni 16 ka të bëjë me marrjen e të dhënave krahasimore, ndërsa pika 3 paragrafi 3.4 parasheh edhe marrjen e të dhënave nga anketimet dhe intervistat me qytetaret e asaj zone. Po ashtu **me qëllim të eliminimit të vërejteve të dhëna nga Gjykata e Apelit**, gjykata e ka obliguar ekspertin në fjalë që të bëjë plotësimin e ekspertizës dhe eksperti me datë 10.04.2021 i ka dorëzuar Gjykatës plotësimin e ekspertizës ku ka elaboruar krahasimet e bëra mes çmimit të shitjes së ngastrave në afërsi me ngastrat objekt shqyrtimi.

Andaj duke i analizuar dhe vlerësuar ekspertizat në fjalë, Gjykata vendosi ti fal besimin ekspertizës së hartuar nga Eksperti Adem Kadolli ing. i diplomuar i bujqësisë për arsye se e njehta është përpunuar në mënyrë profesionale dhe Gjykata të njejtën e vlerëson të drejtë dhe të besueshme për vendosje sa i përket caktimit të lartësisë së shumës në emer të kompenzimit shtesë për shpronësimin e kryer, andaj kësaj ekspertize vendosi ti fal besimin për vendosje.

Gjykata vlerëson se gjatë realizimit të procesit të shpronësimit, organi shpronësues ka vepruar në bazë të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme - Nr. 03/L-139, mirëpo për Gjykatën Organi i Shpronësimit nuk i ka respektuar **rregullat e përcaktuara në nenin 15 të këtij Ligjit** me të cilin përcaktohen rregullat themelore për caktimin e shumës kompenzimit, lidhur me **nenin 22 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme - Nr. 03/L-139** ku përcaktohen rregullat për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, me ç'rast ka ndikuar në vlerësim jo të drejtë të vlerës së paluajtshmërisë së shpronësuar.

Si rezultat i mosvlerësimit të drejtë të vlerës së paluajtshmërisë, Për Gjykatën, propozuesit - ankuesit me të drejtë kanë vepruar në bazë të nenit 36 paragrafi 2 i Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme - Nr. 03/L-139, duke parashtruar ankesën pranë Gjykatës Supreme të Kosovës.

Nën këto rrethana, **Gjykata në kuptim të nenit 16 paragrafi 4 i Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme - Nr. 03/L-139**, ku parashihet:

“Nëse, në përputhje me nenin 36 të këtij ligji, një Person paraqet ankesë pranë gjykatës kompetente lidhur me shumën e kompensimit të përcaktuar në Vendimin Përfundimtar, dhe gjykata nxjerrë një aktgjykim i cili kërkon pagimin e kompensimit shtesë, Organi Shpronësues do të paguajë ose do të kërkojë nga Subjekti Kërkues ose Përfituesi i pritur – nëse ka të këtillë – që të paguajë kompensimin Shtesë” vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi duke e caktuar kompenzimin shtesë dhe shumën e drejta sipas vlerës së paluajtshmërisë së shpronësuar të vlerësuar nga eksperti Adem Kadolli.

Në momentin e vendosjes Gjykata me kujdes shqyrtoi edhe pretendimet e kundërpropozuesit lidhur me atë se vlerësimi është i drejtë dhe shumën e caktuar për kompenzim është e sakt, mirëpo të njejtat pretendime Gjykata i vlerëson të pambështetura në prova materiale, mbi bazën e të cilave prova do të kontestohet ekspertiza e ekspertit Adem Kadolli dhe Gjykatës do i vërtetohej e kundërta.

Lidhur me shpenzimet e procedurës jokontestimore u vendos në bazë të nenit 29 paragrafi 4 i LPJK-së.

Sa i përket refuzimit të kërkesës lidhur me shpenzimet mbi shumat e vendosura si në pikën III të dispozitivit të aktvendimit, Gjykata e arsyeton si vijon; në riprocedurë, seancat e datës 17.12.2020, 21.01.2021 dhe seanca e datës 16.02.2021 nuk janë mbajtur **si rezultat i kërkesës së kundër propozuesit**, andaj Nr.Tarifor 7 mbi Rregullon e OAK për Tarifat e Avokatëve parasheh se për konteste mbi 10,000€ dhe për 4 paditës (këtu propozues) shpërblimi avokatit i takon në lartësi prej 676€ për seancë, ndërsa për çdo seancë të shtyer pa faj të avokatit 50% e shumës së lartëcekur në këtë rast për 3 seanca të pambajtura pa faj të propozuesve u takojn shpenzime **nga 338€ për secilën seancë të pambajtur**, si rrejdhojë rezulton se shpenzimet e procedurës të jenë shkaktuar në lartësin si është vendosur në pikën III të dispozitivit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në pikat e atakuara me ankesë është i drejtë, i ligjshëm dhe në përputhje të plotë edhe me vërtetimin e gjendjes faktike sipas provave të administruara në shkresat e lëndës, ky aktvendim nuk është i shoqëruar me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenit 182 par.2 pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë as në shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore dhe jokontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e ri vendosjes si në aktvendimin e ankimuar, duke vlerësuar drejtë dhe plotësisht provat në shkresat e lëndës, ka bërë vendosje të drejtë dhe të ligjshme, e cila vendosje është bazuar në vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, kjo për faktin se nga provat e administruara rezulton se kundër propozuesja për nevojat e ndërtimit të autostradës “Ibrahim Rugova”, ka shpronësuar ngastrat kadastrale P-2140-0, me sipërfaqe totale të ngastrës së shpronësuar prej 4363 m², si dhe ngastra tjetër kadastrale P-2139-4, me sipërfaqe të shpronësuar prej 4 m², ashtu që, pas nxjerrjes dhe administrimit të ekspertizës së ekspertit të bujqësisë Adem Kadolli e datës 25.02.2014, si dhe ajo e hartuar në procedurën ri gjykuese e datës 10.04.2021 nga ku është vlerësuar se ngastrat lëndore duke aplikuar metodën krahasuese të shitjeve në atë zonë ku gjenden këto ngastra në fshatin Shirokë/Suharekë, është 22 euro për 1 m², dhe për dallim prej organit shpronësues, ku agjensia e kontraktuar “Immobilia”, këto ngastra i ka vlerësuar për çmimin prej 6.50 euro për 1 m², ashtu që, sipas konstatimit të ekspertit të bujqësisë, çmimi total i vlerësuar për dy ngastrat lëndore P-2140-0, me sipërfaqe të shpronësuar prej 4363 m², si dhe ngastra lëndore P-2139-4, me sipërfaqe prej 4 m², është 96,074 euro (nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e katër euro), nga ku shumat e vlerësuar nga organi shpronësues prej 28,504 euro duhet të zbritet nga kjo shumë, rrjedh se diferenca që kundër propozuesja duhet t’ia paguaj propozuesve është shumata totale prej 67,569.74 euro (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e shtatëdhjetë e katër cent), dhe në këtë përlllogaritje, eksperti me të drejtë raportit plotësues të vlerësimit ia ka bashkangjitur edhe kontratat mbi shitblerjet për paluajtshmëritë që janë shitur para procedurës së shpronësimit në atë zonë, nga ky ka marrë si referencë në përcaktimin e çmimit.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo, vlerëson se ekspertiza e ekspertit të bujqësisë Adem Kadolli e datës 25.02.2014, dhe ajo plotësuese e datës 10.04.2021, vlerësohen të drejta, profesionale dhe të hartuara në përputhje të plotë me kriteret dhe metodat e lejuara ligjore, ngase eksperti vlerësues edhe në seancë gjyqësore ka arsyetuar çmimin e vlerësuar, duke konstatuar se sipërfaqet e shpronësuar të ngastrave lëndore, të analizuar dhe shtjelluar si në përmbajtje të ekspertizës dhe plotësimin të saj, ka nxjerr përfundim të drejtë dhe real lidhur me çmimin i cili duhet t’iu kompensohet propozuesve andaj, kjo ekspertizë dhe plotësimi i saj i pranuar nga gjykata e

shkallës së parë, është bindëse, e argumentuar, e sqaruar dhe me përmbajtje e cila në përputhje me të gjithë parametrat vlerësues ka nxjerr përfundimin real të çmimit të tregut në emër të kompensimit për ngastrat lëndore objekt i shpronësimit, prandaj, pretendimet e përfaqësuesit të kundër propozueses rezultojnë të pa bazuara, pa argumentuara dhe më tepër kanë të bëjnë me dyshimet e pa mbështetura lidhur me ngritjen e pa arsytuar të çmimit për kompensim nga grupi i ekspertëve dhe favorizimin e propozuesit e që në rastin konkret këto pretendime nuk u vërtetuan.

Edhe sa i përket të drejtës materiale, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, kur iu është referuar nenit 15 par.1 dhe 2, 18 par.3, nenit 36 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03/L-139, në lidhje me nenin 215, 220, par.1 të Ligjit për Procedurë Jo kontestimore nr. 03/L-007, të cilat autorizojnë gjykatën që të vendosë lidhur me kompensimin në emër të shpronësimit të pronës së paluajtshme, mbi bazën e vërtetuar të gjendjes faktike, nga e cila rezulton i bazuar propozimi i propozuesit për caktimin e kompensimit.

Edhe në raport me kamatën e gjykuar në shkallë prej 7% vjetore si në pikën **III** të dispozitivit të aktvendimit ankimor, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në pajtim me dispozitat e nenit 16 par.2 pika 2 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03/L-139, si dhe në harmoni me Mendimin Juridik për Kamatën të nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës nr. 265/20, dt: 02.12.2020, ku në par. XXII, të këtij mendimi, përcaktohet si përjashtim nga mendimi juridik në fjalë në par. XXII përcaktohet kamatëvonesa që rrjedh nga Ligji për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme ku është përcaktuar kamatëvonesa në shkallë prej 7% vjetore për kompensimin e caktuar nga gjykata, dhe se kjo kamatëvonesë rrjedh nga data e ushtrimit të ankesës-propozimit me datën 15.12.2010 e tutje.

Një ashtu, edhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm edhe sa i përket shpenzimeve të procedurës, duke u vërtetuar të gjitha shpenzimet e shkaktuara në këtë procedurë jo kontestimore, mbi bazën e nenit 29 par.3, lidhur me nenin 222 të Ligjit për Procedurë Jo Kontestimore ngase kundër propozuesja si rrjedhojë e shpronësimit të pronave të paluajtshme të propozuesit duke mos ofruar kompensim proporcional për shpronësimin e terësishëm të ngastrës lëndore, i ka dhënë shkas inicimit të procedurës jo kontestimore nga propozuesit për caktimin e kompensimit të drejtë, real dhe proporcional.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të parashtruesit të ankesës, mirëpo, të njëjtat i vlerësoi si jo qenësore në vendosje ndryshe, ngase të njëjtat ishin pa ndikim vendimtar në vendimmarrje ndryshe nga jo e përcaktuar në gjykatën e shkallës së parë dhe e pranueshme edhe për gjykatën ankimore.

Meqë, pika **IV** e dispozitivit të aktvendimit të ankimuar nuk është atakuar me ankesë nga pala me interes juridik, duke iu përmbajtë kufizimeve ligjore nga neni 194 i LPK-së (kufinj të ekzaminimit të ankesës), si dhe Institutit “Reformatio in Peius” nga neni 203 i LPK-së, këtë pikë të dispozitivit të aktvendimit të ankimuar nuk e shqyrtoi fare.

Prandaj, gjykata e shkallës së dytë, duke marrë për bazë arsyet e cekura si më lartë, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) të LPK-së, lidhur me nenin 3 të LPJK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2020:140492
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05714877

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr.5156/2021, me datë 20.05.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka